

## IN CASUM NECESSITATIS

Rrallëherë ndodh që një lexues i „Hyllit“ ta mos e ndjejë veten mirë, pasi ka lexuar një shkrim të botuar në faqet e revistës. Si një rasë përjashtimore lejohem të citoj këtu shkrimin me titull “Konstitucionet” e *Pal Èllit – të Kuvendit të Matit në vjetin 1462*, botuar numrin e saj fundit (HD 1 [2009] 100 – 127), e që ka për autore zonjën Ledi Shamku-Shkrel, e cila krahas nismës më se të lëvdueshme për të njohur lexuesin e sotëm me tekstin origjinal të vendimeve të atij Sinodi, rreket e rravgon sado përciptas nëpër studimet e mëhershme të filologëve e historianëve shqiptarë e të huaj, duke u përqendruar më pas në “dy observacione të randësishme me natyrë historike dhe gjuhësore që kanë të bajnë me Arbërinë e shek. XV shì në kohën kur ajo përgatitej me u njoftë prej fuqive evropiane si mbretni më vete.” (f. 100)

E këto vëzhgime kanë të bëjnë: a) me një interpretim të ri kontekstual të formulës së pagëzimit në gjuhën shqipe, të cilën pas gjase e paskëshin “thanë e përcjellë me “shmangie” njani mbas tjetrit të gjithë studiuesit, historianë ose jo, që nga Nicolae Jorga e gjer më tash” (f. 121), ndërkohë që vetë nuk ngurron të përfundojë se “e drejta e pagëzimit në kohë të kuvendit të Matit (v. 1462) mbetej ekskluzivisht e klerit” (f. 123); dhe b) shfaqja – sipas saj – për herë të parë e “verbit *Bashtina*, i shkruem kështu me *B* të madhe ...” (f. 124), të cilën “E. Çabej në *Studimet Etimologjike* të tij, pasi sheston paraqitjen e fjalës *Bashtinë* ndër tekstet e njohuna, si dhe shtjellimin e saj nga etimologë dhe albanistë të ndryshëm, e konsideron këtë fjalë si të përshfaqun për herë të parë në “*Mesharin*” e Buzukut, pra më 1555”, ndërsa për autoren kjo fjalë tash duhet të “motnohet thuejse me një shekull, pasi na del qysh në vitin 1462, pra 93 vjet përpëra librit të Buzukut.”<sup>1</sup> (f. 124-5).

1 Këtë fjalë-term të organizimit agrar në Gadishullit Ballkanik gjatë mesjetës, sigurisht që nuk mungon ta citojë vetë Çabej në studimet e tij etimologjike, madje në mënyrë të ndërmjetshme edhe vendburimin e saj në Konstitucionet e Pal Engjëllit (khs. SE II, Tiranë 1976 181: „... non laboraverit in bastina sua“ – më shënim bibliografik veprën e Nicolae Jorga-s). E vëtmja arsyë që ai nuk e tërheq me një shekull shfaqjen për herë të parë të kësaj fjalë në gjuhën e shkruar shqipe, është se ajo si fjalë sllave, përkatësisht në shqipe me burim sllav, dhe si term i organizimit agrar mesjetar në mbarë gadishullin na kumtohet në një tekst të shkruar thjesht

Ky shkrim i zonjës Shamku-Shkreli gjeti vend pak a shumë në të njëjtën kohë dhe me të njëtin tekst të rrjetshëm edhe në faqet e shtypit periodik shqiptar (shih "Gazeta Shqiptare", suplementi "Milosao", dt. 19.04.2009: *Formula e Pagzimit, Kumte të reja nga dokumenti më i vjetër i shqipes*) dhe fatmirësisht reagimi ishte i menjëherëshëm. Autorja u cimbis me bodecin e kritikës qytetare jo vetëm për mungesën e theksuar të etikës profesionale<sup>2</sup>, përkatësisht të qëndrimit të saj thuajse gjithherë nihilist ndaj traditës shkencore albanologjike dhe rezultateve të saj të derisotme<sup>3</sup>, por edhe për boshllëqe të theksuara në formimin e saj filologjik-profesional dhe përgjithësisht në atë intelektual<sup>4</sup>, meqë jo vetëm dhe thjesht përkthimi i paragrafit ku na përshfaqet për herë të parë formula e pagëzimit në gjuhën shqipe është i paqëlluar, por edhe deduktimi kausal që rrjetohi autorja prej vetë atij përkthimi ishte i destinuar mirëfilli të mos ishte fatlum, e kjo në disa pamje: a) gjuhësore, b) teologjike-liturgjike, d) kanonike-fetare, dhe c) kulturore-historike.

Syzimi im i shkurtër, këtu në faqet e "Hyllit", nuk është aspak të

latinisht. Kjo rrethanë nuk e lejon një etimolog me sadopak përvojë që të mëtojë se kemi të bëjmë këtu me një fjalë shqip përkatësisht ta radhi të atë si një dëshmi historike-gjuhësore të shqipes së shkruar në shek. XV. I diskutueshëm në këtë pikë është thjesht dhe vetëm veprimi i zonjës Shamku-Shkreli, e cila s'bën gjë tjetër, veçse merr informacion të gatshëm në studimet e Cabejt, për t'iu kundërvënë pastaj po atij me të njëjtat argumente.

2 Shih reagimet e historianit Kristo Frashëri në gazeten "Tema": *Ledi Shamku dhe "Formula e Pagëzimit"* (25.04.2009); *Përsëri me zonjën Ledi Shamku alias Enkelejda Shkreli I* (25.05.2009) dhe II (26.05.2009). Shih gjithashtu kundërpërgjigjen e autores në po atë gazetë: *Rudhja e "shkërbjeve të shenjtë"* (02.05.2009).

3 Shumë domethënëse në këtë drejtim janë sidomos qëndrimet e saj në parathëni e botimeve anastatike të traditës kulturore albanologjike, të përfshira në gjerdanin "Excipere" (të Shtëpisë Botuese "Çabej"). Një pikë kulmore përfjetojmë në të ashtuquajturën *Parashtresë. Rojë e Continuum-it tonë identitar*, që i paraprin botimit anastatik të fjalorit latinisht- shqip të Frang Bardhit, ku zonja Shamku-Shkreli përdor si diçiturë maksimën e Katonit "Legere et non intelligere, negligere est" – me të cilën, sipas saj (dhe sigurisht gabim – B. D.), Bardhi e paskësh filluar "jo rastësisht Dictionarium-in" – dhe duke thyer çdo normë të etikës intelektuale dhe profesionale lëshon në revan përsiatjet e veta sa ogurzeza aq edhe fyese për brezat e tërë të filologëve shqiptarë e të huaj, të tillë si: "ai [= Bardhi – B.D.] dyshonte se, sikundër kish ndodhur me Budin ca më parë, edhe ai do të lexohej por rrezikonte të mos kuptohej. Dhe ndofta ka pasur të drejtë në dyshimin e tij, pasi ende sot, pas gati 400 vjetësh, vërtet që *Dictionarium-i* është lexuar e rilexuar, porse qëllimi i vërtetë i ndërmarrjes së kësaj nisme në 1635-n largët nga shumëkush është "neglizhuar"; dmth. ky qëllim ose nuk është kuptuar, ose, në është kuptuar, nuk është nxjerrë në pah, pasi i është mëshuar vetëm shqetësimi objektiv të humanistikë lidhur me "ghihuene tane, ghi po bdarete, e po bastarçohete ...". Në fakt qëllimi i Bardhit do ketë qenë më tepër se kaq; *Dictionarium-i*, atij dhe udhërrëfyesve të gjindjes do t'u shërbente si mur mbajtës për truallin, që ai të mos shkimej kundrejt korpusit evropian ..." (Franciscus Blanchus: *Dictionarium latino-epiroticum. Me parathënie nga Mario Roques; Çabej, Tiranë 2006*).

4 Shih reagimin e [Don] Gjergj Metës: *Misteret e formulës së pagëzimit*, në "Gazeta shqiptare", më 26.04.2009.

polemizoj me autoren e shkrimit në fjalë, e aq më pak për gjetjet e saj aspak të gjetura apo për përkthimin e gjymtë të pasazhit latinisht në konstitucionet e Sinodit të Matit.<sup>5</sup> Një polemikë e tillë do ta shpërfillte vetë idealin hyjnor të Hyllit tonë të Dritës: *Ubi Spiritus Domini, ibi libertas*. Kështu që tash po mjaftohem thjesht e vetëm me lutjen ndaj lexuesit me përcjellë me urtësinë e tij dy detaje shtesë:

- a) Së pari: përkthimin shumë më të përshtatshëm të pasazhit në fjalë prej pendës autoritare të Kolë Ashtës, filogut të njohur shkodran dhe njohësit të thelluar të përmendoreve të lashta të shkrimit shqip, i cili bukurtingëllon, si vijon:

“Gjithashtu vendosëm që, veç të tjerave, priftënit, kur pagëzojnë, të shqiptojnë një herë të vetme: *Ego te Baptizo in nomine Patris, et filij et spiritus Sancti*, dhe jo tri herë si kanë thënë gjer mbë sot. Dhe gjithashtu t’i mësojnë besimtarët që t’i pagëzojnë në rasë nevoje foshnjet, që të mos vdesin pa pagëzim përpara se të sillen në kishë, duke thënë së paku në gjuhën popullore shqipe: <*Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit*>. Dhe, në qoftë se ndokush ka qenë pagëzuar në këtë mënyrë, mos të pagëzohet, por të plotësohen uratët dhe gjithçka është lënë jashtë, po qe se ka ndonjë dyshim se mos këto fjalë kanë qenë shqiptuar ose jo prej atij burri ose gruaje, që rastësisht e ka bërë kështu pagëzimin; ky meshtar, që pagëzon, do të hedhë ujin mbi fëmijën tue thënë: në qoftë se je pagëzuar, unë nuk të pagëzoj përsëri, por, në qoftë se nuk je pagëzuar, unë të pagëzoj: *Ego te baptizo in noie [= nomine] Patris et filij et spiritus sancti.*” (Ashta – së fundi në – Leksiku historik i gjuhës shqipe, bl. I, Shkodër 1996, f. 32-3),

- b) Së dyti: të mbajë parasysh gjatë krehjes së përfundimeve në shkrimin e zonjës Shamku-Shkreli edhe një fakt nga historia dhe tradita e Kishës Katolike-Romake në Shqipëri. Është një fakt që mendoj se e përforcon argument(im)in shterues të Don Gjergj Metës, i cili pas korrigjimeve që u bën ndërhyrjeve konceptuale sa të guximshme aq edhe të pasakta të autores në fjalë (shih shën. 4 dhe 5) nuk heziton t’i bashkohet nga një tjetër këndvështrim mendimit të përgjithshëm intelektual dhe albanologjik, sipas të cilët formula e pagëzimit shqip (edhe në shek. XV) lejohej dhe kërkohej të shqiptohej si e tillë edhe nga besimtarët dhe populli

---

<sup>5</sup> Shih Shamku-Shkreli HD 1 [2009] 121, si edhe kritikën e Gjergj Metës art. cit. lidhur me konceptimin e gabuar të kuptimit të fjalëve latine, përkatësisht të termave kishtarë si <parrochus>, <parrochianus>, shq. <shkullar>, <laicus>, <femina> etj.

i thjeshtë në rasë nevoje – *in casum necessitatis* –, lejë dhe kërkesë kjo që ka qenë gjithherë e pranishme në veprimtarinë universale te Kishës Katolike-Romake.

Që këto rrethana dhe mundësi pagëzimi duhet të kenë gjëzuar gjithherë statusin e të drejtës kanonike përgjatë gjithë veprimitarisë së Kishës Katolike-Romake në Shqipëri, për to na kumton shterueshëm teksti normativ-taksativ i vendimeve të Kuvendit të Arbënët, mbajtur në Mërqinjë më janar 1703, aktet e të cilit përjetuan fatmirësisht tre vjet më vonë drithën e botimit të plotë në versionin original latinisht dhe atë të përkthyer shqip.<sup>6</sup> Në pjesën e dytë të tekstit, shi në kreun “De Baptismo” (bot. latin. f. 27-32), përkatësisht “Të pagëzimit” (bot. shqip f. 37-42) i është dhënë hapësirë përkatëse si sakramëntit të pagëzimit me formulën, gjestet dhe ritualin përkatës, ashtu edhe kushteve të dhënies së tij, me synimin e mirë që t'u pritej në një farë mënyre rruga abuzimeve dhe veprimeve të palejueshme nga kleri dhe besimtarët. Në pasazhin që kemi përzgjedhur dhe transkriptuar më poshtë<sup>7</sup> të bien në sy të njëjtat rrethana dhe masa paraprake që u vendosen thuajse dy shekuj e gjysmë më parë edhe në vendimet e Sinodit e Matit. Krh.:

“Mirefilli puna e madhe e kaq misterievet do  
qi nde te mbaituni t' festueshimi te Pagezimit, mā  
fort te vemi roe, mos u mengoft Shakramëntit  
vertyteja e ujimi per faj e pritese te paroqal  
nevet. Pr' ata, tue dashune me qitune uit tri heresh  
n' kryq, forma te flitet veçë nji here me ato fiale:  
*Ego te baptizo in Nomine Patris, et Filii, et Spiritus Sancti;* ndo me i thane shqip: *Une te pagezonj pr' Emeni t' Atit e Birit e Shpirtit Shind.* Te këne  
Parroqt mende mos te nderrohet forma, as ta thone mā, veçë nji here....

<sup>6</sup> Khs. (versionin original latinisht): Concilium Provinciale sive Nationale Albanum. Habitum Anno MDCCIII. Clemente XI – Pont. Max. – Albano. Romæ. Typis Sac. Congregationis de Propaganda Fide, Anno MDCCVI (riprodhim me fototipi në: “Kuvendi i Arbënët” Prishtinë 2003 – Botues Konferenca Ipeshkvore Shqiptare – f. 1 - 130); dhe (versionin e parë të përkthyer shqip): Concili Provinciaal i Cuvendi j Arbenit; Mbelieçune nde viett gna i mijë sctat cint e tre ndene Clementit i Gnimijetmi Pape Pretemaqit, Romæ, Typis Sac. Congregationis de Propaganda Fide, Anno MDCCVI (riprodhim me fototipi në “Kuvendi i Arbënët” Prishtinë 2003 – Botues Konferenca Ipeshkvore Shqiptare – f. 133 - 245). Përkthimi shqip njeh edhe një variante të dytë me autor D. Engjëll Radojën: Concilli i Është Scciyptari Clementit t’Gnimjettit (i kaa citt scciypt Don Egnell Radoja), n’Rom, me sctamp t’cuvenit S.T’ Propagands, 1872. (riprodhim me fototipi në “Kuvendi i Arbënët” Prishtinë 2003 – Botues Konferenca Ipeshkvore Shqiptare – f. 249 - 363).

<sup>7</sup> Markimi me të zeza nga unë – B.D.

... Kendyj me gjith force asht per t'u larguem zā-koni qì malecorete tane shendenonjene e forconjene si me ligj, me zākoni te moçimi, veçe s'dī-ne çish po thone. Marre kane keta nji zākon me pagezuem famijat mbe shtepī te vete: **aty ve Parroqani e i pagezon veçe me uit, pā ceremonia, sikūr pagezohen disa famuj qì Jane nde fill te Morse**, e te tiera esapesh i banjene, perse nuk [a] gatī ndrikulla, ndo kumetri; ..." (f. 37-38)

E më poshtë:

"E nde se veçe parroqanevet perket me pagezuem pro, nde fill te Morse gjithkuj e kudo ep ligma. Veçe asht zākoni i urumit, ndo t' shkiaut me mos pagezuem mbe te madhe nevoje, veçe priftinit e tyne. Te qellonjene paroqt me larguem keta murtaje prej mendesh se mprapshtueme; kinese te derremohet prej katoliqsh ajo pune qì mizori i moçimi pā pushuem nde per goje te shkievet arretoi per te keq te Shpirtit.

E kinese mbasndaj mos te pagezonjene te dyitene here e mā mpos te medhenjete me mkat te Sakrilegjit, tue perterim Shakramentin per se dyiti, te shquretonjene paroqt a asht pagezuem aj qì do me u pagezuem? E ndemos muiçin me zgiedhune te vertetene, po te jene nderdëm, para se ta pagezonjene me kondicione, sikūr me thane (ndemos jē pagezuem, une te pagezonj) te i mpsonjene artikuite e Fëse e ligjet e nevoishima e te Kershtenitet e te i banjene me gjegjune urdhenimit te Shen Pietrit Principi i Apostujet." (f. 39)

Pasazhi i mësipërm, sikurse i gjithë kreu "Te pagëzimit" në aktet e Kuvendit të Arbënët tumirin bindshëm dhe shterueshëm faktin që sakramenti i pagëzimit ka qenë dhe mbetet pa dyshim një e drejtë ekskluzive e institucionit të kishës, i cila *në fill të morsë* [= në prag të vdekjes – B.D.] i njihte *gjithkuj e kudo* – pra edhe atij shqipfolësit të thjeshtë e të panjollë në tëbanën e vet –, të drejtën e pagëzimit *in vulgari Albanico: |Un te pagezonj pr'Emeni t' Atit, e t' Birit, e t' Shpertit Shenjt|*. Ishte bash kjo formulë farëmirë që i dha atij dorë për t'i vënë shpërgënjtë kulturës së shkrimit shqip *in casum necessitatis*.

## **SUMMARY**

Focusing on The Christening Formula, as the earliest ever written document in Albanian has been called, the article asserts the importance of the Sacrament of Baptism among the Christians and underlines the fact that it was an exclusive right of the Church to administer it. Starting from this preliminary remark Prof. Demiraj tackles the questions of when, why and who wrote the Formula in mediaeval Albanian. The author also expresses his disagreement with Prof. Ledi Shamku – Shkreli, albanologist on this issue.